



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmjen / Predato Received / Delivery	04.12.2023	3	viti god year
Organ / Mjesta Organ / Mjesto Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shitja Prilog Appendix	Sasta Kolicina Quantity
SKANSHCK	7203/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1256/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-krjetare, Arben Mehmeti dhe Arditë Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1256/2023 të datës 05.10.2023 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi: Rruga , në Komunën e Prishtinës, kundër Vendimit me numër reference Nr.Ref.BD-173/3 të datës 30.11.2023 Bordit të Drejtorëve në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.12.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON PROCEDIMI ADMINISTRATIV i filluar ma ankesën me numër A.nr.1256/2023 të datës 05.10.2023 të parashtruar nga ankuesja , për shkak që objekti i ankesës është bërë i pamundur.

Arsyetim

Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, duke u bazuar në Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore për Organizimin e Agjencisë së Pavarur, si dhe nenin 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik po ashtu nenit 13,14,15 dhe 16 të Rregullores me numër Nr.14/2020 për Transferim të Nëpunësve Civil, si dhe duke u bazuar edhe në Udhëzuesin me numër Nr.02/2022 për procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit, më datë 04.09.2023 ka nxjerrë Vendimin me numër reference: Nr.Ref.BD-186/39 përmes së cilit e ka aprovuar Rregulloren me numër Nr.05/2023 për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ankuesja, e punësuar sipas Akt Emërimit me numër reference: 37/DBNJ 1 të datës 10.01.2023 në pozitën e punës „Drejtor i Burimeve Njerëzore“ në Departamentin e Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, e pakënaqur me Vendimin me

numër reference: Nr.Ref.BD-186/39 të datës 04.09.2023 të nxjerrë nga Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, më datë 05.10.2023 ka parashtruan ankesë me numër protokollin 6404/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ndërsa Këshilli më datë 26.10.2023 ka pranuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit përgjigjen në ankesë e cila është protokolluar me numër Nr.prot.1256/2023 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me shifër: VK/2023 dhe numër protokollin Nr.prot.7017/2023 të datës 17.11.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1256/2023 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollin 6404/2023 të parashtruar nga ankuesja më datë 05.10.2023 në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër me numër reference: Nr.ref.BD-173/3 të nxjerrë më datë 30.11.2023; Rregulloren Nr.07-2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit të datës 30.11.2022; Organogramin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Nëntor 2022; Akt Emërimit me numër reference: 37/DBNJ 1 të datës 10.01.2023; Akt Emërimit me numër reference: 08/DBNJ 1 të datës 07.03.2018; E-mail i datës 20.09.2023; E-mail i datës 17.05.2023; E-mail i datës 27.12.2023; Listën e pagave për muajin shkurt 2023; Listën e pagave për muajin Mars 2023; Listën e pagave për muajin shtatorë 2023; E-mail i datës 27.12.2023; Metodologjinë për Vlerësimin e vendeve të Punës me Qëllim të Klasifikimit të tyre Shkurt 2023; Rregulloren (ZKM) NR.03/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Industrisë, Ndërrmarësisë dhe Tregtisë; Vendimin me numër reference: Nr.ref.BD-186/39 të nxjerrë më datë 04.09.2023 nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve; Rregulloren Nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit të datës 04.09.2023; Organogramin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 04.09.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 18.10.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokollin Nr.prot.1256/2023 të datës 26.10.2023; E-mailin e datës 06.10.2022; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 10.09.2018; E-mailin e datës 27.02.2023; Pliko me numër Nr.3499; Vendim me numër VK/2023 dhe numër protokollin 7017/2023 i datës 17.11.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedure dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses, *është e bërë i pamundur, sepse:*

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se me aprovimin e Rregullores Nr.05-2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës shihet qartë se është bërë degradimi i pozitës së saj nga niveli i mesëm drejtues në nivelin e ulte drejtues gjithashtu pretendon se Komisioni i Ristrukturimit si dhe Bordi Drejtorëve nuk kanë pasur mandat ligjor që të bëjnë klasifikimin e pozitive por vetëm sistematizimin/transferimin e zyrtarëve të prekur nga ky proces,

gjithashtu kërkon nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyes Civil të Kosovës, që të aprovoj ankesën e ankueses si dhe të anulohet struktura Organizative si dhe Rregullorja me numër Nr.05/2023 për Sistematizimin e Pozitave të punës në AKP, më saktësisht pjesa e nivelit të ulët drejtues Divizioni i Burimeve Njerëzore, gjithashtu të obligohet AKP që pozitën e Divizionit të Burimeve Njerëzore ta rikthej në pozitën e mesme drejtuese.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, gjate shqyrtimit të ankesës është njoftuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit se *ankuesja me datë 30.11.2023 përmes emailit ka njoftuar Drejtorin Ekzekutiv dhe Njësinë e Burimeve Njerëzore lidhur me dorëheqjen e saj nga pozita e Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar faktin e lartpërmendur, ka konstatuar se meqenëse ankuesja ka dhënë dorëheqje nga pozita e saj e punës, atëherë konsideron që objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses është bërë i pamundur apo i kotë, sepse me këtë rast nuk ka objekt të shqyrtimit, kështu në pajtim me dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë"*, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka bërë përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me ankesën me numër A.nr.1256/2023 të datës 05.10.2023 të parashtruar nga ankuesja Liana Xharra-Tolaj, për shkak që objekti i ankesës është bërë i pamundur.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1256/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencia Kosovare e Privatizimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

